



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1225/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Pjetër Coli, kandidat për anëtar të kuvendit komunal nga radhët e PDK-së në Klinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të manipulimit me vota, për Zgjedhjet Lokale në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Pjetër Coli kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Klinë, nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK).

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 03.12.2013 në ora 15:35 nga Pjetër Coli kandidat për anëtar të kuvendit komunal, duke pretenduar se në vendvotimin nr:0803/02R në Zllakuqan të Klinës të numërohen votat e tij pasi që numri i votuesve është më i madh se numri i votave që posedon 19 vota në këtë vendvotim, thuhet në pretendimet e ankuesit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesën gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesën e kandidatit për anëtarë të kuvendit komunal nga radhët e PDK-së Pjetër Coli, konstatoi se pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës nuk janë të argumentuara në fakte konkrete dhe dëshmi, pasi që ankuesi në fjalë nuk i ka bashkangjitur dëshmi bindse me qëllim të vërtetimit të shkeljes së supozuar. Andaj, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, ankesa vlerësohet si e pa bazë, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr. 1225/2013 më datën 06.12.2013.



**Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani**

Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.